Procesverbali i mbledhjes date 27.02.2026

Sot ne sallen e mbledhjeve te K. B. Devoll zhvillohet mbledhja e radhes sipas njoftimit te dates 20.02.2026. Te pranishem ne salle:
Valbona Spaho, Oljana Comka, Esmeralda Medolli, Kledi Cenkolli, Festim Kaso, Oliver Mulla, Trifon Meraku, Lindita Cokani, Vladimir Gjyli, Albana Skoti, Genti Demcolli, Ermena Xhaci, Giela Hoxhalli, Vladimir Kello, Alfredi Gjata.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 1, miratimin e rendit te dites.
Hapet votimi: 15 pro, 0 kunder, 0 abstenim.
Alfredi Gjata: Vazhdojme me miratimin e procesverbalit te dates 13.02.2026.
Hapet votimi: 14 pro, 0 kunder, 1 abstenim.
Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 3 , Projekt-Vendim Nr.17 Datë 16.02.2026 , " Për një ndryshim të vendimit nr.4, datë 28.01.2026 per detajimin e përdorimit të fondit të grantit të bazuar në performance dhe shtesë në buxhetin e vitit 2025 "
Alfredi Gjata: duhet specifikuar, sepse herën e parë e vendosëm të përdoret për fonde për kulturën, por e vendosëm të përdoret për fonde për kulturën.
Kemi rënë dakord të gjithë të behet monument i valles Devollice.
Hapet votimi: 15 pro, kunder, 0 abstenim.
Alfredi Gjata: Vazhdojmë me pikën 4 Projekt-Vendim Nr.18 Datë 16.02.2026 , " Për një ndryshim me vendimin nr 82 date 25.11.2025 "Per miratimin e linjave per transportin e punonjesve arsimore qé punojné dhe te nxënesve që mësojne jashtë vendbanimit."
Në sallë vjen keshilltari Ilir Hoxha. Bëhen 16 këshilltarë.
Hapet votimi: 16 pro, 0 kunder, 0 abstenim
Alfredi Gjata:Vazhdojmë me pikën 5 Projekt-Vendim Nr.19 Datë 16.02.2026 , "Për rishqyrtimin për dhënien e titullit qytetar nderi për Z.Ridvan Vait Bode."
Alfredi Gjata: Mendoj ta lëmë për në fund, mqs do të kerkoje votim te fshehte.
Genti Demcolli: Me fal, z.Kryetar i këshillit, për çfarë arsye në fund ?
Alfredi Gjata: Do na duhet te gjithe te lëvizim nga vendet për ta votuar.
Genti Demcolli: Po lëmë punët dhe po vijmë për këtë mbledhje.Nese ju duhen akoma njerez se sjane plotesuar karriget . Merri me rradhe pikat.
Trifon Meraku: Mënyra më e drejtë me njerëzit është mos merresh me gjera te vogla , jo e lëmë në fund apo fillim. Për ne s'është problem, sepse gjykojme tendencën tënde të keqe dhe nuk mund të detyrosh njerëz.
Alfredi Gjata: Çështjet personale i lëmë jashtë.
Ligji thote qe nuk mund te dekorosh me shume se dy ne vit me tituj nderi qe mos krijohet inflacion me këto dhe po të ishte për mua do e bënim me konsensus. Ne skemi ardhur te bejme lufte ketu.
Per sa i perket dy sygjerimeve qe kan ardhur , Prf. Maqo na dha nje leksion qytetarie, tha une nuk kam bere gje pervec detyres dhe me shume me ka dhene Devolli se sa i kam dhene.
Vladimir Kello : Uroj që ky këshill të tregojë nivel profesional në lartësi. Të mos merremi me vogëlsira dhe gjëra personale.
Cdo gje eshte e percaktuar ne ligj.

Eliverta Pavliqoti: PV ka bashkëngjitur procesverbalet e komisioneve për çdo mbledhje sipas procedurës. Janë ndjekur hapat me rradhe dhe janë vënë në dispozicion vetëm CV.
Gjithashtu ne kerkuan informacion nga autoriteti i dosjeve të cilat i gjeni bashkëngjitur.

Në sallë janë Imelda Çuçka dhe Arsina Mazelliu.

Vladimir Kello : Citon ligjin per qytetar nderi , kështu gjithesecili te prezantohet dhe votohet.
Oljana Comka: Tek relacioni thuhet që ka ardhur vetëm një CV për këtë person? Çfarë do të thotë kjo?

Eliverta Pavliqoti: Kontribute qe mund te kete dhene , por keto i sjell propozuesi. Pra nëse do kishte dokumente ku vertetonin kontribute të veçanta.
Genti Demcolli: Sot me kete votim qe do bejme mmendoj qe vendosim nje standart per kete keshill. Dyshemeja e kontributeve te personit ne fjale, duhet te jete ketu. Nuk kemi. Tani sa i perket pikave tel dokumentacionit qe duhej dorezuar, jo gjithmone memoria eshte e shkruar por edhe njerezore. Keshtu qe mendoj ska nevoje per shume fjale.
Hapet Votimi: 14 pro, 2 kunder, 2 abstenim.

Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 6 Projekt-Vendim Nr.20 Datë 16.02.2026 " Për miratimin e shtesës në inventarin e pronave të paluajtshme shtetërore qe kerkohet te kalohen ne pronesi te Bashkise Devoll te pasurive kadastrale te pasurive me numer: 321; nr. 323; nr.324; nr.325; nr.326; nr. 327; nr.330; nr. 331; nr.333; nr.342; nr.512; nr.513; nr.514; nr.515; nr.516Zk.1202 fshati Bitincke.
Erjon Rado: *shpjegon siperfaqet dhe vendndodhjet.
Eduard Duro: Jane prona te kaluara me VKM per tu regjistruar ne hipoteke.
Vladimir kello: Ka inventar te plote per pronat e Bashkise?
Eduard Duro: PEr momentin skemi tentativa per te na marre pronat.
Hapet Votimi: 18 pro, 0, kunder, 0 abstenim
Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 7 Projekt-Vendim Nr.21 Datë 20.02.2026 "Për miratimin e ndihmës ekonomike nga fondi kushtëzuar deri në 6 % për bllok- ndihmën ekonomike për muajin Janar 2026".
Nuk ka diskutime.
Hapet Votimi: 18 pro, 0, kunder, 0 abstenim
Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 8 Projekt-Vendim Nr.22 Datë 20.02.2026 "Për miratimin e planit vendor të barazisë gjinore Bashkia Devoll 2026-2028"
Nuk ka diskutime.
Hapet Votimi: 18 pro, 0, kunder, 0 abstenim
Alfredi Gjata: Vazhdojme me piken 10 Projekt-Vendim Nr.23 Datë 20.02.2026 "Për miratimin e kritereve te pranimit te perfituesve ne qendren shumefunksionale e komunitare te Bashkise Devoll viti 2026."
Zerina Sinani: Janë mbi 150 persona për marrjen e shërbimeve, por janë të ndarë me kategori.
Bëjmë aktivitete të shumta sensibilizuese.